



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-2019-05

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatëse An Pauër-Ford, Kryetare
Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Roland Dekers

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 7 shkurt 2019

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Referim dhe kërkesë për masë të përkohshme nga Mahir Hasani lidhur me urdhrin e Prokurorisë të datës 20 dhjetor 2018

Klasifikimi: Publik

**Urdhër në lidhje me kërkesën e Mahir Hasanit për masë të
përkohshme**

Parashtruesi

Mahir Hasani

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

An Pauër-Ford, kryetare
Vidar Stensland, gjykatës
Roland Dekers, gjykatës

pasi kuvendoi në seancë private më 25 dhe 26 janar 2019, lëshon Urdhrin e mëposhtëm.

I. PROCEDURA

1. Më 15 janar 2019, z. Mahir Hasani ("Parashtruesi") i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") një referim që mban datën 11 janar 2019 ("Referimi"),¹ në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta"). Parashtruesi përfaqësohej nga Dr. Artan Qerkini.

2. Në Referim, Parashtruesi bën ankesë se Urdhri i Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që e urdhëron atë të paraqesë dokumente dhe informacione ("Urdhri"), cenon të drejtat e tij për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten, si edhe prezumimin e pafajësisë. Parashtruesi mbështetet në nenet 30(6) dhe 31(5) të Kushtetutës dhe në nenin 6(2) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

3. Gjithashtu, Parashtruesi ka paraqitur kërkesë në bazë të rregullës 21(1) dhe (2) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e Punës"), për urdhër në formën e një mase të përkohshme i cili pezullon

¹ KSC-CC-2019-05, F00001, Peticion i z. Mahir Hasani për konstatim të cenimit të të drejtave themelore të tij nga Zyra e Prokurorit të Specializuar përmes lëshimit të Urdhrit VIY689 të datës 20 dhjetor 2018 për të paraqitur dokumente dhe të dhëna dhe kërkesë për masë të përkohshme, Publik (i redaktuar me shtojca konfidenciale, 11 janar 2019).

Urdhrin e lartpërmendur të ZPS-së deri në marrjen e vendimit nga Dhoma për pranueshmërinë dhe themelësinë e Referimit.

4. Më 15 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), caktoi panelin e lartpërmendur për t’u shprehur në lidhje me Referimin.²

5. Më 18 janar 2019, Kryetarja e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 3(8)(c) të Ligjit, bëri kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të kësaj procedure në shtetin pritës, përkatësisht në Holandë.³ Në të njëjtën ditë, në bazë të nenit 20 të Ligjit, paneli vendosi që gjuhët e punës për këtë procedurë të jenë shqipja dhe anglishtja, me përkthim zyrtar me shkrim ose me gojë në gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara - shqipe, serbishte, dhe anglishte – të mundësuar nga Zyra Administrative.⁴

6. Më 18 janar 2019, Dhoma e njoftoi Prokurorin e Specializuar lidhur me parashtrimin e përgjigjes.⁵ Dhoma e lejoi Prokurorin e Specializuar që deri më 25 janar 2019 të parashtronte përgjigjen e tij ndaj kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme, në rast se dëshironte.

7. Më 22 janar 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara lëshoi vendimin për vendin e zhvillimit të procedurave në fjalë në shtetin pritës.⁶

² KSC-CC-2019-05, F00002, Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, publik, 15 janar 2019.

³ KSC-CC-2019-05, F00004, Kërkesë për ndryshimin e vendit të zhvillimit të procedurës, publike, 18 janar 2019.

⁴ KSC-CC-2019-05, F00005, Vendim mbi gjuhët e punës, publik, 18 janar 2019.

⁵ KSC-CC-2019-05, F00003, Njoftim në lidhje me parashtrimin e përgjigjes, publik, 18 janar 2019.

⁶ KSC-CC-2019-06, F00002, Vendim për vendin e zhvillimit të procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

8. Më 25 janar 2019, Prokurori i Specializuar dorëzoi parashtrimin e tij në përgjigje të kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme.⁷

II. FAKTET

9. Më 20 dhjetor 2018, ZPS-ja i dorëzoi Parashtruesit dy dokumente, përkatësisht një fletëthirrje për t'u paraqitur për marrje në pyetje më 11 shkurt 2019 ("Fletëthirrja") dhe Urdhrin për t'i dorëzuar ZPS-së dokumente dhe informacione të caktuara në të njëjtën ditë.

10. Në Urdhër, ZPS-ja shprehej se Parashtruesi ishte "i detyruar t'i paraqiste" të gjitha dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuar në Urdhër dhe paralajmërohej se mosparaqitja e dokumenteve "do të konsiderohet mosbindje"⁸ dhe si rezultat i kësaj, ZPS-ja mund të kërkonte nga Dhomat e Specializuara që të merrnin masa që detyrojnë bindjen ndaj Urdhrit.

11. Në Urdhër thuhej gjithashtu se kishte "arsye për të besuar se [Parashtruesi] [ishte] përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës [...]".⁹

12. Në Fletëthirrje thuhej se Parashtruesi ishte "i detyruar të paraqitej"¹⁰ për t'u marrë në pyetje. Më tej, në Fletëthirrje thuhej edhe se në rast mosparaqitjeje të Parashtruesit, ai mund "të detyrohej të paraqitej, të gjobitej dhe të burgosej".¹¹

⁷ KSC-CC-2019-05, F00008, Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës së z. Mahir Hasani për masë të përkohshme, publike, 25 janar 2019.

⁸ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 3, konfidenciale.

⁹ Po aty.

¹⁰ KSC-CC-2019-05, F00001, A03, Shtojca 2, konfidenciale

¹¹ Po aty.

III. PARASHTRIMET

A. PARASHTRUESI

13. Parashtruesi argumenton se Urdhri i ZPS-së konfirmon se ekziston dyshim se Parashtruesi është përfshirë në kryerjen e një krimi brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në të njëjtën kohë, Urdhri e detyron Parashtruesin të paraqesë të gjitha dokumentet dhe informacionet e specifikuar në të. ZPS-ja nuk e ka informuar Parashtruesin për hollësitë e dyshimit ndaj tij. Për këtë arsye, ai argumenton se Parashtruesi mund të gjendet në një situatë ku, pasi t'i ketë paraqitur ZPS-së dokumentet dhe informacionet, këto materiale më vonë mund të dëmtojnë mbrojtjen e tij dhe ZPS-ja do të fitojë një avantazh të palejueshëm, nëse ndaj Parashtruesit do të ngrihet aktakuzë për kryerjen e një veprë penale.

14. Bazuar në sa më sipër, Parashtruesi thotë se si rezultat i këtij detyrimi për të paraqitur dokumente dhe informacione, që cenon të drejtën e tij për të heshtur dhe privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes, ekziston një rrezik real i dëmit të rëndë ndaj të drejtave të tij themelore sipas neneve 30(6) dhe 31(5) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës. Urdhri e detyron Parashtruesin t'i paraqesë ZPS-së dokumente dhe informacione dhe, për këtë arsye ai, si person i dyshuar, duhet ta zbatojë urdhrin.

B. PROKURORI I SPECIALIZUAR

15. Prokurori i Specializuar parashtron se Dhoma nuk duhet ta miratojë masën e përkohshme. Në këtë fazë, skenari sipas të cilit ndaj Parashtruesit do të ngrihet aktakuzë dhe dokumentet do të përdoren kundër tij është hamendësues. Masat e përkohshme nuk kërkohen për të trajtuar ndonjë dëm teorik që mund të shkaktohet në të ardhmen. Përpos kësaj, Parashtruesi nuk do t'i nënshtrohet asnjë kërcënimi prej ZPS-së për masë kundër tij, nëse më 11 shkurt 2019 ai merr një vendim të lirë dhe të bazuar në informacion. Në paraqitjen e tij atë ditë, ZPS-ja do ta informojë Parashtruesin për të drejtat e tij në përputhje me nenin 38(3) të Ligjit, përfshirë të

drejtën për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten. Për këtë arsye, nuk ka rrezik real të dëmit të rëndë.

16. Gjithashtu, Dhoma nuk mund të lëshojë urdhër për masë të përkohshme sepse Referimi është *prima facie* i papranueshëm. Ligji parashikon shumë nivele të mbikëqyrjes gjyqësore në lidhje me çështjet e ngritura në Referim, si shqyrtimi nga një gjykatës i vetëm ose një gjykatës i procedurës paraprake, të caktuar në bazë të nenit 33 të Ligjit. Parashtruesi nuk i ka shteruar këto mjete juridike.

IV. VLERËSIM

A. JURIDIKSIONI

17. Përpara se Dhoma të trajtojë kërkesën e Parashtruesit për masë të përkohshme dhe pavarësisht nga urgjenca e çështjes, është e udhës të trajtohet shkurtimisht çështja e juridiksionit.

18. Parashtruesi e ka paraqitur Referimin në përputhje me nenin 113(7) të Kushtetutës. Referimi ka të bëjë me Urdhrin e ZPS-së. Në pamje të parë, Referimi lidhet me Dhomat e Specializuara dhe me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, siç e kërkon neni 162(3) i Kushtetutës, dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Dhoma është bindur se, *prima facie*, ajo ka juridiksion të marrë vendim në lidhje me Referimin. Si rrjedhojë, Dhoma ka juridiksion të marrë vendim për masën e përkohshme.

B. MASA E PËRKOHSHME

19. Duke iu kthyer kërkesës së Parashtruesit për masë të përkohshme, Dhoma vëren së pari se Parashtruesi i ka përmbushur kriteret e përcaktuara në rregullën 21(2) të Rregullores së Punës.

20. Dhoma rikujton gjithashtu se në përputhje me rregullën 21(1) të Rregullores së Punës, urdhër për masë të përkohshme mund të jepet nëse individi përballlet me “një

rrezik real të dëmit të rëndë” në rast mosmiratimi të masës së përkohshme. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se neni 116(2) i Kushtetutës parashikon një kusht të ngjashëm në të cilin Gjykata Kushtetuese mund të vendosë masë të përkohshme, në veçanti nëse veprimi i kontestuar do të shkaktonte “dëme të pariparueshme”.

21. Sipas sistemit të Konventës, rregulla 39 e Rregullores së GJEDNJ-së parashikon mundësinë që Gjykata të shprehet për masë të përkohshme. Rregulla nuk i shtjellon arsyet mbi bazën e të cilave Gjykata mund të shprehet për masë të përkohshme.¹² Në rastet kur vepron neni 6, praktika e Gjykatës së Strasburgut është që të zbatojë rregullën 39 (pra, të miratojë masë të përkohshme) në rrethanat kur personi rrezikohet të pësojë një “*mohim flagrant të drejtësisë*” në rast dëbimi ose ekstradimi.¹³

22. Për sa i përket ekzistencës së “rrezikut real të dëmit të rëndë” sipas rregullës 21(1) të Rregullores së Punës, Parashtruesi argumenton se në qoftë se Dhoma nuk e pezullon Urdhrin e ZPS-së që e urdhëron atë të paraqesë dokumente më 11 shkurt 2019, dëmi me të cilin përballet ai është i trefishtë. Në rast se statusi i tij do të ndryshojë nga i dyshuar në të akuzuar, (i) mbrojtja e tij do të dëmtohet dhe (ii) Prokuroria do të fitojë një avantazh të padrejtë. Në rast se refuzon t’i paraqesë dokumentet, (iii) ai do të akuzohet për mosbindje, me mundësinë që ndaj tij të merren masa që detyrojnë bindjen sipas kushteve të Urdhrit.

23. Prokurori i Specializuar i kundërshton argumentet e Parashtruesit (shih paragrafët 15-16 më lart).

24. Deri më sot, Dhoma nuk ka pasur mundësi të zhvillojë jurisprudencën e vet mbi atë se çka përbën ‘rrezik real të dëmit të rëndë’, në marrjen e vendimit për miratim ose jo të kërkesës për masë të përkohshme. Dhoma mban parasysh kushtin e ‘mohimit

¹² Shih ECtHR, *Mamatkulov and Askarov v. Turkey* [GC], nos. 46827/99 and 46951/99, ECHR 2005-I, para. 104.

¹³ Në lidhje me këtë, shih ECtHR, *Soering v. the United Kingdom*, 7 korrik 1989, Series A no. 161; *Othman (Abu Qatada) v. the United Kingdom*, nr. 8139/09, ECHR 2012; *Ismoilov and Others v. Russia*, no. 2947/06, 24 prill 2008.

flagrant të drejtësisë' të shprehur nga Gjykata e Strasburgut. Ndonëse Dhoma mendon që argumenti i Prokurorit të Specializuar se Parashtruesi do të informohet në lidhje me të drejtat e tij për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten ka njëfarë peshe, në këtë moment Dhoma e ka të vështirë ta pajtojë atë parashtrim me kushtet e 'Urdhrit' që e *detyrojnë* Parashtruesin të dorëzojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e specifikuar kur të paraqitet për t'u marrë në pyetje më 11 shkurt 2019.

25. Në këtë moment Dhoma është e mendimit se në pamje të parë Urdhri i ZPS-së është problematik për sa i takon kërkesave të drejtësisë, sepse përbën një urdhër për një të dyshuar të konfirmuar që të dorëzojë materiale të cilat, nëse Urdhri zbatohet, mund t'i shkaktojnë Parashtruesit dëm të rëndë nëse statusi i tij do të ndryshojë nga i dyshuar në të akuzuar. Në rast moszbatimi, Urdhri paralajmëron se mosparaqitja e dokumenteve "do të konsiderohet mosbindje".

26. Dhoma vëren se Urdhri e *detyron* Parashtruesin të dorëzojë dokumentet dhe informacionet e kërkuara. Ajo vëren gjithashtu se Parashtruesit i bëhet paralajmërimi sipas të cilit mosparaqitja e dokumenteve konsiderohet mosbindje, çka mund të sjellë fillimin e masave detyruese ndaj Parashtruesit. Sipas kushteve të Urdhrit, Parashtruesi nuk ka zgjedhje tjetër përveçse të zbatojë urdhrat e dhënë në të dhe të paraqesë dokumentet e kërkuara, në qoftë se dëshiron të shmangë konstatimin për mosbindje.

27. Mbi bazën e sa më lart dhe duke mbajtur parasysh afatet e kufizuara kohore brenda të cilave bëhet kërkesa për masë të përkohshme, Dhoma është e gatshme të pranojë se ekziston rrezik real i dëmit të rëndë në rast mosmiratimi të masës së përkohshme.

28. Për këtë arsye, në rrethanat shumë specifike të këtij rasti, Dhoma vendos të miratojë një masë të përkohshme që pezullon Urdhrin e ZPS-së deri në marrjen e vendimit për Referimin, ose deri në një urdhër të mëtejshëm.

29. Dhoma konfirmon se ky Urdhër i Dhomës që miraton masën e përkohshme nuk bën gjë tjetër përveçse siguron ruajtjen e statukuosë deri në marrjen e vendimit për Referimin.

30. Dhoma konfirmon se ky Urdhër i Dhomës nuk paragjykon vendimin në lidhje me Referimin, duke përfshirë edhe çfarëdo konstatimi që mund të bëjë Dhoma në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e tij.

31. Dhoma konfirmon gjithashtu se ky Urdhër i Dhomës nuk paragjykon detyrimin e Parashtruesit për t'u paraqitur sipas Fletëthirrjes për marrje në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar më 11 shkurt 2019.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

Pezullon Urdhrin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të datës 20 dhjetor 2018 duke qenë se *detyron* Parashtruesin e Kërkesës të paraqesë dokumentet, të dhënat, shënimet dhe informacionet e specifikuar në Urdhër, deri kur Dhoma të shprehet për Referimin, ose deri në një urdhër të mëtejshëm.

/nënshkrimi/

Gjykatëse An Pauër-Ford
Kryetare e Dhomës

Hartuar në anglishte, të enjten më 7 shkurt 2019
Në Hagë, Holandë.